

Nr.regj. 14819/2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Afrim Haliti, nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar me nenin 17 parag. 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, Nr. 04/L-050, në bazë të nenit 73, 74, 198 al.1 pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZK 23/79 (LK), me datë **30.07.2012**, merr këtë:

AKTVE N D I M

Dep.		Nr. Prot.	
Dep.	<u>DPK / DMP</u>	B. Prot.	<u>03-2742/12</u>
Dep.		Prot. No.	
Nr. Ifaq.		Data	<u>03.08.2012</u>
Broj. shënime	<u>01</u>	Datum	
Nr. daniës		Data	

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

PEZULLOHET procedura kundërvajtëse ndaj Afrim Sherif Haliti, i lindur më **24.08.1973** në Pejë, ku edhe jeton, me vendbanim në rrugën "Bike Aliu" nr.1, këshilltar politik në Ministrinë e Forcës dhe Sigurisë, për kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar me nenin 17 parag. 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, Pezullimi bëhet komfor nenit 198 al.1 pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, pasi që nuk ka prova se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë me kërkesë, Shpenzime të procedurës nuk ka pasur.

Nga një kopje e aktvendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës dhe personit Afrim Haliti.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, i parashtrori kësaj gjykate Kërkesën 01-1600/2012 me datë 02.05.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të lartshënuarit për kundërvajtjen nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar me nenin 17 parag. 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse, mori në pyetje të pandehurin i cili në mbrojtjen e vet theksoi se në pozitë të këshilltarit politik në MFS me kompensim nga mjeet e Buxhetit të Kosovës ka filluar me datë 02.04.2012, për çka prezantoi si dëshmi Vendimin Nr.18 të MFS të datës 03.04.2012, ndërsa paraprakisht nga data 10.10.2011 deri më 09.03.2012 kishte punuar në MSF si konsultat-këshilltar i CDF në MFS, por me kompensim nga mjetet e KFOS, për çka prezantoi Kontratën nr.20 11/58 të datës 11.11.2011.

Për të vërtetuar gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike, gjyqtarja ftoi edhe parashtruesin e kërkesës në cilësi të dëshmitarit, sipas Autorizimit t të datës 12.07.2012, i cili pasi vështrroi dokumentet e prezantuara nga zyrtari Afrim Halit, shprehu pajtimin për validitetin e të njëjtave duke theksuar se nga pika kontaktuese e MFS ka pranuar listën e zyrtarëve të lartë ku është i përfshirë edhe emri Afrim Haliti, përndryshe sikur të ishte në dijeni për gjendjen reale të Afrim Halitit, me siguri AKK nuk do të kishte parashtruar kërkesën për iniciimin e procedurës për kundërvajtje.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas vlerësimit të deklaratës së të pandehurit dhe parashtruesit të kërkesës, gjyqtarja në masë të mjaftueshme vërtetoi gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike, se Afrim Haliti nuk ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë, andaj në mungesë të provave, gjyqtarja komfor nenit 198 al.1 pika 8 të LK, e Pezulloi procedurën kundërvajtëse ndaj të lartshënuarit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

Nr.regj.14819/2012, me datë **30.07.2012**

Gjyqtarja
Suzana Çerkin

KËSHILLA JURIDIKE: Kundërvajtjet aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të ushtrojë Ankesë Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh pas pranimit të këtij aktvendimi, në këtë gjykatë, pa taksa.

